



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Nr. 3272/14 prot.

Tiranë, më 23.10.2023

VENDIM

Nr. 93, datë 23.10.2023

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR PROCEDURAT
E INSPEKTIMIT TË VEPRIMTARISË AUDIOVIZIVE TË OFRUESVE
TË SHËRBIMIT MEDIATIK AUDIO DHE/OSE AUDIOVIZIV”,
MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 101, DATË 07.06.2017, TË AMA-S**

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, gërma “e” të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA),

V E N D O S I:

1. Miratimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren “Për procedurat e inspektimit të veprimtarisë audiovizive të ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv”, miratuar me vendimin nr. 101, datë 07.06.2017 të AMA-s, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi i AMA-s nr. 101, datë 07.06.2017 “Për procedurat e inspektimit të veprimtarisë audiovizive të ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv të amendohet sipas ndryshimeve dhe shtesave të bëra.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:

Armela

KRASNIQI

Zëvendëskryetar:

Desada

METAJ

Anëtarë:

Aurela

BICJA

Besian

ZOGAJ

Gjergji

HAMITI

Jetmir

HALILAJ

Joana

ALLUSHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
DREJTORIA E INSPEKTIMIT DHE MBIKQYRJES
(Miratuar me vendim nr.93, datë 23.10.2023 të AMA-s)

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN
“PËR PROCEDURAT E INSPEKTIMIT TË VEPRIMTARISË AUDIOVIZIVE TË
OFRUESVE TË SHËRBIMIT MEDIATIK AUDIO DHE/OSE AUDIOVIZIV”,
miratuar me vendimin nr. 101, datë 07.06.2017 të AMA-s, .

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, gërma “e” dhe nenit 78 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në vendimin nr. 101, datë 07.06.2017 të AMA-s “Për miratimin e rregullores ‘Për procedurat e inspektimit të veprimtarisë audiovizive të ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv’”, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Në nenin 4 të rregullores bëhet riformulimi i fjalisë si më poshtë:

Ishte: “AMA, në mënyrë që të realizojë një inspektim sa më efektiv, do të udhëhiqet nga parimet e mëposhtme”:

Bëhet: “AMA, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së inspektimit, udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:...”

Në nenin 13 të rregullores bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Neni 13

Ishte: **Detyrimet e subjektit të inspektimit**

Përveç sa parashikohet nga ligji i posaçëm, subjekti i inspektimit ka këto detyrime gjatë veprimtarisë së inspektimit:

1. Të ketë, ose të vërë në dispozicion të paktën një punonjës, ose një person të autorizuar prej tij, në çdo kohë (24 orë në ditë, për 7 ditë të javës), në vendin/mjediset ku janë të vendosura pajisjet audio dhe/ose audiovizive. Punonjësi, ose personi i autorizuar në

- fjalë konsiderohet si përfaqësues i subjektit që inspektohet dhe ka të njëjta të drejta dhe detyrime gjatë inspektimit;
2. Në rast se nuk dëshiron, ose nuk ka mundësi të komunikojë drejtpërdrejt me inspektorët, të caktojë një përfaqësues, si dhe t'i shoqërojë ata në çdo vend/mjedis të përmendur në pikën 1 të këtij neni;
 3. Të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e veprimeve të inspektimit. Mungesa e bashkëpunimit vlerësohet bashkë me provat e tjera;
 4. Të sigurojë një vend të përshtatshëm për punën e inspektorëve, nëse inspektimi kryhet në vendin e ushtrimit të veprimtarisë, si dhe t'u ofrojë atyre qasje të plotë në pajisjet dhe/ose infrastrukturën në posedim apo administrim;
 5. Të paraqesë çdo informacion, të dhënë, ose dokument, si dhe të japë çdo shpjegim për faktet e rrethanat e konstatuara dhe të nevojshme për inspektimin, nëse kërkohet nga inspektorët, duke respektuar edhe afatin kohor të përcaktuar prej tyre;
 6. Të lejojë dhe të mundësojë marrjen e dëshmive nga punëmarrësit e tij, nëse kjo kërkohet nga inspektorët.

Bëhet:

Përveç sa parashikohet nga ligji i posaçëm, subjekti i inspektimit ka këto detyrime gjatë veprimtarisë së inspektimit:

1. *Përgjatë fashës orare 08.00-20.00, vendi/mjediset ku janë të vendosura pajisjet audio dhe/ose audiovizive, duhet të jenë të hapura dhe të kenë të paktën një përfaqësues present. Punonjësi, ose personi i autorizuar në fjalë konsiderohet si përfaqësues i subjektit që inspektohet dhe ka të njëjta të drejta dhe detyrime gjatë inspektimit. Mosrespektimi i këtij detyrimi konsiderohet moslejim i inspektimit.*
2. *Pas orës 20.00 deri në orën 08.00, të vendosë në dispozicion të paktën një punonjës, ose një person të autorizuar prej tij, në çdo kohë (për 7 ditë të javës), i cili duhet të jetë në dispozicion të AMA-s kur kjo e sheh të arsyeshëm. Personi mund të mos jetë fizikisht në studion e transmetimit, por duhet të jetë gjithmonë i aksesueshëm sa here që inspektorët e AMA-s e kërkojnë .*
3. *Në rast se nuk dëshiron, ose nuk ka mundësi të komunikojë drejtpërdrejt me inspektorët, të caktojë një përfaqësues, si dhe t'i shoqërojë ata në çdo vend/mjedis të përmendur në pikat 1 dhe 2 të këtij neni;*
4. *Të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e veprimeve të inspektimit. Mungesa e bashkëpunimit vlerësohet bashkë me provat e tjera;*
5. *Të sigurojë një vend të përshtatshëm për punën e inspektorëve, nëse inspektimi kryhet në vendin e ushtrimit të veprimtarisë, si dhe t'u ofrojë atyre qasje të plotë në pajisjet dhe/ose infrastrukturën në posedim apo administrim;*
6. *Të paraqesë çdo informacion, të dhënë, ose dokument, si dhe të japë çdo shpjegim për faktet e rrethanat e konstatuara dhe të nevojshme për inspektimin, nëse kërkohet nga inspektorët, duke respektuar edhe afatin kohor të përcaktuar prej tyre; Të lejojë dhe të mundësojë marrjen e dëshmive nga punëmarrësit e tij, nëse kjo kërkohet nga inspektorët.*